



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË**



RREGULLORE

MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË BOTIMEVE NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË

(e përditësuar)

**Miratuar me Vendimin nr. 41, datë 29.04.2022,
ndryshuar me Vendimin nr. 102, datë 03.10.2025,
të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë**

Neni 1 **Baza ligjore**

1. Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
2. Ligji nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.
3. Statuti i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;
4. Rregullorja e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;
5. Aktet të tjera nënligjore që rregullojnë/normojnë botimet në institucionet publike të arsimit të lartë.

Neni 2¹ **Qëllimi**

Këshilli i Botimeve shkencore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë (UMT) është organ kolegjial, i cili ka për qëllim të përcaktojë standardet që duhet të përmbushin botimet akademike dhe shkencore në UMT, në procesin e mësimdhënies dhe në aktivitetin kërkimor-shkencor.

Neni 3 **Kompetencat e Këshillit të Botimeve në UMT**

Kompetencat e Këshillit të Botimeve në UMT janë:

- a. Përcakton kriteret që duhet të përmbushin leksionet e shtypura të lëndëve, tekstet origjinale, tekstet e huaja të përkthyer dhe monografite.²
- b. Përcakton standardet dhe kriteret që duhet të përmbushin revistat shkencore dhe në përgjithësi i gjithë periodiku shkencor ku publikohen artikujt shkencorë që pranohen si të tillë nga UMT-ja. Bashkëpunon me njësitë bazë (Departamentet), njësitë kryesore, komisionet e përhershme, Këshillin e Etikës, njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe Senatit Akademik të UMT-së për certifikimin e nivelit dhe cilësisë së botimeve shkencore.
- c. Ndjek funksionimin e revistës/ave shkencore dhe periodikëve shkencorë të UMT-së, përcakton kriteret që këto periodikë duhet të përmbushin, propozon këshillin editorial dhe shkencor të këtyre periodikëve dhe ndjek aktivitetin e tyre.
- d. Bashkëpunon me Këshillin e Etikës lidhur me respektimin e parimeve dhe rregullave të etikës dhe deontologjisë së botimeve shkencore.

¹ Ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 102, datë 03.10.2025.

² Ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 102, datë 03.10.2025.

Neni 4

Përbërja

1. Këshilli i Botimeve shkencore në UMT është organ kolegjal, përbërja e të cilit propozohet nga Rektori, pas një procesi përzgjedhës të përshkruar në rregulloren e UMT-së dhe miratohet nga Senati Akademik i UMT-së. Këshilli i Botimeve i UMT-së përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, personel akademik me kohë të plotë të stafit akademik të kategorisë “Profesor”, nga të cilët minimumi 1 (një) anëtar të jetë nga Fakulteti i Mjekësisë, minimumi 1 (një) anëtar të jetë nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike dhe minimumi 1 (një) anëtar të nga Fakulteti i Mjekësisë Dentare. Numri i anëtarëve me titullin “Profesor i Asociuar”, nuk mund të jetë më i madh se 2 (dy).
2. Përzgjedhja e anëtarëve propozohet nga Rektori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë pas një procesi përzgjedhës të përshkruar në Rregulloren e UMT-së dhe miratohet nga Senati Akademik i UMT.
3. Mandati i anëtarëve është 4 (katër) vjeçar i rinovueshëm.
4. Këshilli i Botimeve zgjedh me votim Kryetarin dhe Zv. Kryetarin.
5. *Pranë Këshillit të Botimeve dhe në mbështetje të tij funksionon sekretariati, i cili mban procesverbalet e mbledhjeve dhe arkivën e Këshillit të Botimeve. Në sekretariat bëjnë pjesë Kryetari, Zv/kryetari, si dhe një sekretar pa të drejtë vote, nga kategoria personel ndihmës akademik me kohë të plotë në strukturën e Rektoratit të UMT, i cili ndihmon Këshillin e Botimeve për kryerjen e veprimtarisë së tij funksionale.³*

Neni 5

Funksionimi

1. Këshilli i Botimeve funksionon sipas Rregullores së tij të Brendshme të miratuar në Senatin Akademik. Ai përcakton standardet që duhet të përmbushin botimet akademike dhe shkencore në UMT, në procesin e mësimdhënies dhe aktivitetin kërkimor-shkencor.
2. *Seancat e Këshillit të Botimeve nuk janë publike. Për çdo mbledhje mbahet një procesverbal i detajuar nga Sekretari i Këshillit të Botimeve, i cili nënshkruhet në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse nga të gjithë anëtarët e pranishëm dhe nga Sekretari.⁴*
3. Këshilli i Botimeve mblidhet sa herë të jetë e nevojshme, por si rregull jo më pak se 6 (gjashtë) herë në vit. Ai mblidhet me kërkesën e Kryetarit ose të zëvendësit të tij.
4. Mbledhja nuk mund të zhvillohet pa shumicën e thjeshtë të anëtarëve (50%+1).
5. *Si rregull, rendi i ditës i bëhet i ditur anëtarëve të paktën 1 (një) javë para mbledhjes. Për raste të veçanta, me kërkesë të jo më pak se 3 (tre) anëtarëve të tij, mund të kërkohet zhvillimi i mbledhjes deri në 48 orë përpara zhvillimit.⁵*

³ Ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 102, datë 03.10.2025.

⁴ Ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 102, datë 03.10.2025.

⁵ Ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 102, datë 03.10.2025.

Neni 6⁶

Marrja e vendimeve

1. *Këshilli i Botimeve merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, me përjashtim të rasteve kur të paktën 2/3 e anëtarëve të pranishëm në mbledhje, vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve, për çështje që nuk janë në rendin e ditës.*
2. *Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit (4 anëtarë).*
3. *Si rregull, votimi është i hapur. Këshilli rast pas rasti, mund të vendosë për çështje për të cilat vlerëson se, për marrjen e vendimeve, votimi duhet të jetë i fshehtë.*
4. *Anëtarët e Këshillit, që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të votuar, shprehin qëndrimin e tyre “pro”/“kundër”. Mendimi “kundër” paraqitet me shkrim dhe i bashkëlidhet vendimit.*
5. *Kryetari i Këshillit voton i fundit. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.*
6. *Vendimet nënshkruhen nga Kryetari i Këshillit.*
7. *Në marrjen e vendimeve, anëtarët e Këshillit të Botimeve duhet të ushtrojnë funksionin e tyre në shërbim të interesit publik dhe duhet të jenë të pavarur, të paanshëm dhe objektivë.*

Neni 7

Detyrat e Kryetarit dhe Zv. Kryetarit

1. Ka të drejtë të thërrasë mbledhjen e Këshillit të Botimeve në UMT.
2. Përcakton rendin e ditës.
3. Organizon shqyrtimin e dosjeve.
4. Përfaqëson Këshillin e Botimeve të UMT-së pranë instancave universitare, autoriteteve publike dhe të tretëve.
5. Zv. Kryetari merr detyrat e Kryetarit në mungesë të tij.

Neni 8

Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit të Botimeve

Shpërblimi i anëtarëve dhe sekretarit të Këshillit të Botimeve në UMT bëhet konform vendimeve përkatëse të organeve kolegjiale përkatëse/përgjegjëse.⁷

Neni 9

Miratimi dhe ndryshimi i Rregullores

1. Kjo Rregullore e Këshillit të Botimeve miratohet në mbledhjen e parë të Këshillit të Botimeve me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve.

⁶ Ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 102, datë 03.10.2025.

⁷ Ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 102, datë 03.10.2025.

2. Ajo mund të ndryshohet me iniciativë të Kryetarit, Zv. Kryetarit ose me kërkesën e 2/3 te anëtarëve të pranishëm të Këshillit të Botimeve apo dhe me kërkesë të organeve, autoriteteve apo personelit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.⁸

Neni 10 Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, Rregullorja e Këshillit të Botimeve në UMT, miratuar nga Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë më 26.11.2014, shfuqizohet.

Neni 11 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Emri, mbiemri,
Nënshkrimi, Vula e institucionit

⁸ Ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 102, datë 03.10.2025.